



Dalës-lizazna

Nr. -1-109
Br.

Data 31.07.2018
Datum

OBILIĆ-OBILIC



**Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government**

Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 12.2, pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008), nenit 44.1 dhe 47.3, të Statutit të Komunës dhe nenit 39 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kuvendi komunal pas shqyrtimit të kërkesës nr. IX-182, të dt.17.07.2018, në mbledhjen e mbajtur me dt.31.07.2018, mori këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Drejtorisë për Mbrojtje dhe Mjedis për vënjen nën mbrojtje të këtyre vlerave natyrore të cilat do të ruhen nga DMM në bashkëpunim me MMPH – Instituti për mbrojtje të natyrës dhe atë:


- Trungjet e dushkut në Sibofc
- Trungun e blirit në Sibofc
- Burimin e ujit mineral në Grabovc të Epërm dhe
- Trungun e manit në Mazgit

2. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

T'i dërgohet

- Kryetarit
- Kryesuesit
- Nënkryetarit
- DMM
- MAPL-së
- Anëtarëve të Kuvendit
- Arkivit

Kryesuesi i Kuvendit Komunal


Burim Gërguri





REPUBLIC OF KOSOVO
17/07/2018
Republika e Kosovës
Republika Kosovo- Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government



Komuna Obiliq - Skupština Obilić - Municipality Obiliq
Drejtoria për Mbrojtje dhe Mjedis

Data:	16/07/2018
Nga:	Fitore Hashani-Drejtore për Mbrojtje dhe Mjedis
Permes:	Xhafer Gashi - Kryetar i komunës
Për:	Burim Gërguri - kryesues i kuvendit
Lënda:	Kërkesë për vënjen në mbrojtje të monumenteve të natyrës

Drejtoria për Mbrojtje dhe Mjedis bazuar në kërkesën e MMPH-së, përkatësisht Institutit për Mbrojtjen e Natyrës, u drejtohet me këtë kërkesë për vënjen nën mbrojtje të këtyre vlera natyrore.

- o Trungjet e dushkut (*Quercus robur*) në Sibovc,
- o Trungun e blicit (*Tilia argentea*) në Sibovc,
- o Burimin e ujit mineral në Grabovc të Epërm dhe
- o Trungun e manit (*Morus nigra*) në Mazgit.

Pas takimeve dhe konsultimeve me institutin në fjalë, nga komuna konkretisht Kuvendi kërkohet procedonimi për kuvend për vënjen nën mbrojtje të këtyre vlera natyrore, të cilat do të ruhen nga DMM në bashkëpunim me MMPH – Instituti për Mbrojtje të Natyrës.

Për më të detajuar bashkangjitur e gjeni kërkesën dhe sqarimet nga MMPH-ja, si dhe vendimet që propozon DMM –ja, për procedurat e mëtejshme.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING

AGJENCIA E KOSOVËS PËR MBROJTJEN E MJEDISIT	KOSOVSKA AGENCIJA ZA ZAŠTITU SREDINE	KOSOVO ENVIRONMENTAL PROTECTION AGENCY
DATË/A:	06.06.2018	
REFERENC-Ë:	154/AMMK/2018	
PËR/ZA/TO:	Arben Berisha Drejtor i Drejtorisë për Mbrojtjen e Mjedisit në Komunen e Obiliqit	
NGA/OD/FROM:	Dr.sc Ilir Morina, Kryeshef Ekzekutiv i AMMK	
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Kerkesë për venje në mbrojtje të monumenteve të natyrës	

I nderuar

Duke marrë parasysh gjendjen e krijuar në terren si dhe duke pasur parasysh humbjen e vlerave të disa monumenteve natyror për të cilat qysh në vitin 2005 ishin propozuar për vënie nën mbrojtje ligjore nga ana e Kuvendit Komunal të Komunës së Obiliqit, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës/Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës propozon si në vijim:

1. Kuvendi Komunal i Obiliqit brenda një periudhe sa më të shpejtë të propozoj vënien nën mbrojtje të këtyre vlerave natyrore:

- o Trungjet e dushkut (*Quercus robur*) në Sibovc,
- o Trungun e blirit (*Tilia argentea*) në Sibovc,
- o Burimin e ujit mineral në Grabovc të Epërm dhe
- o Trungun e manit (*Morus nigra*) në Mazgit.

Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës Tel. 038 200 33 228. email: kepa@rks-gov.net
Adresa: rruga Luan Haradinaj ish pallati i mediave "Rilindja" kati i VI/04, 10000 Prishtinë

II. Monumentet natyrore; Kompleksin e drunjëve të qarrit dhe shkozës si dhe Kompleksin e ujërave në Brezhnieë për shkak që kanë humbur vlerat natyrore për të cilat ishin propozuar për mbrojtje të mos procedohen më tutje;

III. Pas nxjerrjes së vendimeve për mbrojtjen e këtyre monumenteve të njostohet MMPI/ AMMK-ja.

Bashkangjitur e ke edhe përgjigjen e IKMN-së.

Me respekt





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministartvo Sredine i Prostorog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

AGJENCIONI PËR MBROJTJEN
E MJEDISIT TË KOSOVËS

KOSOVSKA AGENCIJA
ZA ZAŠTITU SREDINE

KOSOVO ENVIRONMENTAL
PROTECTION AGENCY

DATË/A:		21.03.2018	
REFERENC-Ë:		435 IKMN/2018	
PËR/ZA/TO:		Hir Morina, kryeshef ekzekutiv i AMMK-së	
CC:			
PËRMES/PREKO/THROUGH:		Fadil Bajraktari, drejtor i IKMN-së	
NGA/OD/FROM:		Qenan Maxhuni, zyrtar për biodiversitet Sami Behrami, zyrtar për zona të mbrojtura	
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:		Raport nga vizita monitoruese e Monumenteve të Natyrës në komunën e Obiliqit	
Nr. i zyrës:	1403	Lokacioni:	Prishtinë
Br. kancelarije:		Kuçi:	
Room No.:		Extension:	
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION		Data:	21/03/2018
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL		Datum:	
PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE		Date:	
PËR KOMENTE/ZA KOMENTARE/FOR COMMENTS			
A MUND TË DISKUTOJME/DALI MOZEMO RASPRAVLJATI/MAY WE DISCUSS			
VËMENDJA JUAJ/VASA PAZNJA/YOUR ATTENTION			
SI PAS DISKUTIMIT/KAKOJE RASPRAVLJENO/AS DISCUSSED			
SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/AS REQUESTED			
SHËNIM DHE PËRCJIGJE/BELIESKA I ODGOVOR/NOTE AND RETURN			
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASH INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION			
AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE			

Page 1 of 4

1
IKMN

Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK-MMPH)
Adresa: Rruga "Luan Haradinaj" Ndërtesa e Re e Qeverisë, kati XV/04, 10000 Prishtinë
Tel. 03820033228, e-mail&web: KETPA@rks-gov.net, www.ammk-rks.net

I nderuari Kryeshf,

Me qëllim të monitorimit të gjendjes së monumenteve të natyrës të propozuara për mbrojtje në territorin e Komunës së Obiliqit, me datë 14.03.2018 ekipa e IKMN-së në bashkëpunim me zyrtarin për mjedis në këtë Komunë, z. Lulëzim Mjekiçi vizitoi këto vlera natyrore.

Paraprakisht me z. Mjekiçi u realizua një takim zyrtar në ambientet e Komunës ku e njoftuam më gjerësisht lidhur me procedimin e këtyre propozimeve qysh nga viti 2005 si dhe mundësinë e riaktualizimit të kësaj çështjeje dhe procedimin e tanishëm për vënien mbrojtje të këtyre monumenteve.

Me këtë rast u vizituan këtë monumente natyrore:

- Trungjet e dushkut (*Quercus robur*) në Sibovc,
- Trungun e blirit (*Tilia argentea*) në Sibovc,
- Burimin e ujit mineral në Grabovc të Epërm,
- Kompleksin e drunjëve të qarrit dhe shkozës në Grabovc të Epërm,
- Kompleksin e ujërave në Brezhnicë dhe
- Trungun e manit (*Morus nigra*) në Mazgit.



Foto 1. Trungjet e rrënjës në Sibovc




Foto 2. Burimi i ujit mineral në Grabovc




Foto 3. Trungu i blirit në Sibovë




Foto 2. Kompleksi i ujërave në Brezhnicë

Gjatë kësaj vizite u konstatua gjendja relativisht e mirë e disa prej monumenteve të propozuara për mbrojtje qysh në vitin 2005, si ajo e Trungjeve të Rrënjës dhe alij të Blirit në Sibovë ndërsa Kompleksi i drunjtëve të qarrit dhe shknozës përkundër që nuk posedonte vlera të mjaftueshme natyrore ai gjithashtu edhe nuk kishte gjendje të mirë.

Gjendja e burimit të ujit mineral në Grabovë nuk ishte e mirë meqë gati sa nuk ishte mbuluar nga dheu përreth dhe mezi dallohej nga jashtë por megjithatë edhe si i tillë nga ai vazhdonte të buronte ujë mineral dhe me një përkujdesje më të madhe nga ana e nivelit komunal do të mund të kishte një pamje edhe më të mirë.

Vizita vazhdoi tek Kompleksi i ujërave në Brezhnicë me ç'rast u konstatua gjendja jo e mirë e tij e gjithashtu një sasi shumë e vogël e ujit që rrëdhte prej tij.

Duke marrë parasysh gjendjen e krijuar në terren si dhe duke pasur parasysh humbjen e vlerave të disa monumenteve natyror për të cilat qysh në vitin 2005 ishin propozuar për vënie nën mbrojtje ligjore nga ana e Kuvendit Komunal të Komunës së Obiliqit, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës propozon si në vijim:

- Kuvendi Komunal i Obiliqit brenda një periudhe sa më të shpejtë të propozoj vënien në mbrojtje të këtyre vlerave natyrore:
 - o Trunget e dushkut (*Quercus robur*) në Sibovc,
 - o Trunget e blirit (*Tilia argentea*) në Sibovc,
 - o Burimin e ujit mineral në Grabovc të Epërm dhe
 - o Trunget e manit (*Morus nigra*) në Mazgit.
- Monumentet natyrore: Kompleksin e drunjëve të qarrit dhe shkozës si dhe Kompleksin e ujërave në Brezhnicë për shkak që kanë humbur vlerat natyrore për të cilat ishin propozuar për mbrojtje të mos procedohen më tutje;
- Pas nxjerrjes së vendimeve për mbrojtjen e këtyre monumenteve të njoftohet MMPH/ IKMN-ja.

Me respekt.